



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.546/22

GJYKATA KOMERCIALE -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “V... LLC”, me seli në Gjakovë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve SCLR Partners sh.p.k me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2808/19, të datës 09.09.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.11.2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë- Ministria e Financave, Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2808/19, të datës 09.09.2021, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizion Fiskal, A.nr.2808/19, të datës 09.09.2021, është aprovuar si e bazuar kërkesëpapia e paditësit “V... LLC”, me seli në Gjakovë, ndërsa është anuluar aktvendimi nr.01.3.2.2/10936-2017, i datës 14.10.2019, i Doganës së Kosovës në Prishtinë dhe është obliguar e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë që paditësit “V... LLC, me seli në Gjakovë t’ia kthej shumën prej 5,991.86 euro (pesë mije e nëntëqind e nëntëdhjetë e një euro e tetëdhjetë e gjashtë cent), të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore (DUD-it) me nr R-.... i datës 27.07.2019, të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore në Pejë-Terminal, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, ndërsa secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës, për shkak të: shkeljeve të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë

të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës, ndërsa të anulohet aktgjykimi i ankimuar, apo të refuzohet kërkesëpadia e paditësit në tërësi si e pabazuar dhe të lihet në fuqi vendimi i kontestuar si i ligjshëm, ose të prish aktgjykimin e atakuar dhe lëndën ta kthej në gjykatën e shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Paditësi nuk ka paraqit përgjigje në ankesë.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre nenit 81.G të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr.01.3.2.2/10936, i datës 14.10.2019, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedurë "V... LLC", me seli në Gjakovë, për rishqyrtimin e vendimit R-..../27.07.2019, të ZD Pejë si e pabazuar.

Paditësi i pakënaqur me aktvendimin e Doganës së Kosovës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 26.11.2019, me pretendim se i njëjti është i paligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr.01.3.2.2/10936, i datës 14.10.2019, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke anuluar aktvendimin e lartcekur të Doganës së Kosovës në Prishtinë. Me arsyetim se e paditura-Spektori për Rishqyrtimin e vendimeve ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimit R-.... të datës 27.07.2019 të ZD Pejë, me të cilin vendim paditësit i është rivlerësuar vlera e deklaruar e mallit, me arsyetimin se sektori i pranimit qendror ka vepruar drejtë kur ka konstatuar e mallit lëndor, pasi që vlera e mallit të deklaruar për zhdoganim nuk është vlerë reale e paguar për mallin me qëllim importi në vendin tonë, për arsye se, është deklaruar vlera më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport, përkatësisht import në vendin tonë, në vështrim të nenit 33 të KDAK-së, gjykata e shkallës së parë konstaton se aktvendimi i kontestuar nuk është i drejtë dhe nuk është bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkëlqe qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkëlqe gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 81I par 2 pika 2.2 të Ligjit Nr.04/L-102 dhe neni 46 par 4 të LKA-së, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në

padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, ky pretendim nuk qëndron meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe KDAK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gjithashtu kjo gjykatë konsideron se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e të paditurës janë të pa bazuara, ngase nga provat e administruara, gjykata nuk ka mundur që të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, për arsye se e paditura nuk ka provuar ta vërtetoj gjendjen faktike nga dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor që ka paraqit paditësi në procedurën administrative dhe para gjykatës, por ka aplikuar direkt të dhëna e disponueshme që i disponon për mallin e njejtë duke ju shmangur kështu vlerësimit të dokumentacionit, përderisa në anën tjetër paditësi ka paraqit provat që dëshmojnë se është paguar vlera e transaksionit nga neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109.

Kolegji i kësaj gjykate, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes gjen se gjykata e shkallës së parë nuk ka gjetur fakte të bazuara që argumentojnë konstatimin se paditësi ka deklaruar vlerën më të vogël se sa vlera reale e paguar për eksport në vendin tonë në vështrim të neni 33 të Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës. Kështu e paditura me asnjë provë konkrete nuk ka dëshmuar se paditësi i ka paguar eksportuesit të mallit vlerën më të lartë se sa vlera e deklaruar me DUD-in kontestues dhe faturën përcjellëse të mallit lëndor. Prandaj, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se e paditura ka aplikuar metodën e 6 të vlerësimit nga neni 35 i Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, ku ka theksuar se është i papranueshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109 . Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, kjo gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur është bazuar në dispozitat e LPA, LKA, Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, si dhe Kodit nr.03/L-109 Doganor dhe të Akcizave në Kosovë.

Dhoma e Shkallës së Dytë i pati parasysh edhe pretendimet ankimore të palës së paditur lidhur me faktin se në rastin konkret është dashur të caktohet një ekspertizë financiare për të vërtetuar lartësinë e kërkesës së palës paditëse, si dhe faktin që gjykata e ka marr për bazë lartësinë e kërkesës e cila është caktuar në seancë, mirëpo pretendimet e tilla kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara e sidomos për faktin se nga shkresat e lëndës vërtetohet se e paditura ka qenë e ftuar në mënyrë të rregulltë por nuk ka prezantuar në seancë, ku edhe ka mundur që të propozoj ekspertizë financiare në mënyrë që ti vërtetoj pretendimet e veta. E për më tepër me parashtrësën e tij të datës 02.09.2021 ka deklaruar se gjykata të veprojnë në pajtim me nenin 38 par 5 të LKA-së.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të

paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë fare nuk ka administruar provat e lëndës, pasi dokumentacioni i prezantuar nga paditësi nuk përputhet në kuptim të vlerës nga fatura shoqëruese e mallit dhe tarsnfereve bankare, këto pretendime ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara, të pa argumentuara në prova konkrete dhe nuk kanë mbështetje ligjore për tu aprovuar ankesa, për faktin se gjykata e shkallës së parë nga administrimi i të gjitha provave në këtë procedurë të konfliktit administrativ me të drejt ka ardhur në përfundim se e paditura nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t'ia dëshmojë provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor, është vlerë e transaksionit e paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç parashihet me dispozitën ligjore nga neni 33 të KDAK-së, apo se paditësi ka paguar vlerë më të lart eksportuesit-shitësit të mallit, se sa vlera e deklaruar me DUD-in kontetsues R-..../27/07.2019 ZBD Pejë, por në rastin konkret e paditura vlerësimin e mallit lëndor e mbështet në të dhënat e disponueshme të Doganës së Kosovës nga neni 35 i KDA-së. Prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate në rastin konkret është vërtetuar bindshëm dhe në mënyrë të pa kontestuar se ekzistojnë prova të mjaftueshme që dëshmojnë se paditësi ka paguar vlerën e vërtetë të transaksionit të mallit lëndor . Andaj, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, ashtu që ankesa e paditurës u refuzua si e pa bazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË
K.DH.SH.II.nr.546/22, me datë 10.11.2022

Kryetare e kolegjit,
Franciska Zhitja Ymeri